



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.10.2023)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 11:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami; Gjithashtu nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Fatmira Luli dhe znj. Brikena Ukperaj.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Çështja e cila është për trajtim, sipas njoftimit të bërë, në rendin e ditës datë 24.10.2023, ora 11:00, lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, për të relatuar relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën zoti Kurushi për të vijuar me relatimin e relacionit të përgatitur për caktimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Deri më datë 23.10.2023, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim disa kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, e Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme: Bëhet fjalë për tre çështje penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t’i nënshtrohen shortit elektronik, sipas tabelës në relacion).

Për çështjen e parë, kërkohet caktimi i 2 (dy) gjyqtarëve për plotësimin e trupit gjykues në çështje penale të themelit me të pandehur shtetasin {...} etj. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtar {...}, i caktuar më parë me vendim të KLGJ-së si gjyqtar i seancës paraprake. Kanë pengesë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} pasi kanë kryer veprime paraprake; Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin penal në ngarkim të të pandehurve {...} etj. Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin nr.{...}, datë 14.12.2022 në ngarkim të pandehurit në procedim të lidhur {...}; Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin për dosjen nr. {...} regje, datë 05.12.2022 në ngarkim të pandehurit në procedim të lidhur shtetasi, {...} etj; Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë në gjykim të pandehurin në procedim të lidhur me shtetasin{...}.

Për çështjen e dytë, kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues në dosjen penale të seancës paraprake me të pandehur shtetasin {...}, etj. Dosja e mësipërme është ndarë nga dosja me të pandehur {...} etj; (në relacion citohet më gjerë).

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Për çështjen e tretë, kërkohet caktimi i 3 (tre) gjyqtarëve për plotësimin e trupit gjykues në dosjen penale me të pandehur {...}, {...} etj; *(më gjerë trajtohet në relacion.)*

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 6 (gjashtë).

Për 3 (tre) çështje, për të cilat kërkohet respektivisht dy, një dhe tre gjyqtarë, të përzgjidhen me short 6 (gjashtë) të tillë, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit *(në relacion përmenden emrat e gjyqtarëve)*. Bashkëlidhur relacionit është edhe lista e gjyqtarëve të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret për t’iu nënshtruar shortit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale (çështja nr. 114) gjyqtarët Artan Jahollari (relator), Migena Laska dhe Adelajda Gjuzi (anëtarë).

Për çështjen nr. 2, penale (çështja nr. 112), gjyqtarët Ilir Përdeda dhe Ardit Mustafaj.

Për çështjen nr. 1, penale (çështja nr. 99), gjyqtarja Nurjeta Tafa.

Mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor